



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AVOKATI I POPULLIT

**Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202300887/7

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2024

**Lënda:** Sugjerojmë trajtimin e rastit në interesin më të lartë të fëmijës S.J

**DREJTORISË SË KOPSHTIT TË FËMIJËVE  
"TRËNDAFILAT E BARDHË" BILISHT**

**DEVOLL**

*Për dijeni:*

**Znj.I. J.  
BILISHT**

**DEVOLL**

Të nderuar,

Sic ju kemi vënë në dijeni edhe përmes korrespondencës zyrtare me Ju, shtetasja I. J., banuese në Bilisht, Devoll ka paraqitur një ankesë pranë institucionit të Avokatit të Popullit. Ajo është prind i një fëmije (S. J., e datëlindjes 4.12.2019) që ka qenë e regjistruar në kopshtin e fëmijëve "Trëndafilat e Bardhë", Bilisht. Ankuesja shprehet se gjatë vitit arsimor 2022-2023 fëmija ka ndjekur grupin e I-rë të kopshtit, e regjistruar me datë 4.12.2022, kur ishte 3 vjeçe. Në datën 11.09.2023, sipas ankueses, ajo duhet të vazhdonte grupin e II-të, por nga drejtoria e kanë rikthyer në grupin e I-rë, gjë të cilën prindërit e fëmijës e kundërshtojnë. Ndaj, si prind i fëmijës, ankuesja ka bërë kërkesë me shkrim pranë drejtorisë së kopshtit ku të dy prindërit janë shprehur se ata nuk janë informuar asnjëherë që fëmijës do t'i jepej përkujdesi, por do të ripërsëriste grupin e I-rë të kopshtit. Shprehimisht prindërit e fëmijës kanë parashtruar se: "Mungesat e fëmijës, ashtu si të gjithë bashkëmoshatarët e tjerë të tij mund të kenë qenë për arsye të ndryshme, qoftë edhe për arsye shëndetësore. Gjatë verës kopshti nuk frekuentohet nga asnjë fëmijë".

Po ashtu në kërkesë ata kanë pretenduar se nga Ministria e Arsimit këtë vit shkollor është lejuar regjistrimi në shkollë i fëmijëve edhe pa e mbushur moshën 6 vjeç në ditën e fillimit të vitit shkollor.

Avokati i Popullit, ju është drejtuar Ju dhe Bashkisë Devoll me kërkesa për të marrë shpjegime lidhur me trajtimin e këtij rasti.

Referuar përgjigjes që kemi marrë nga Bashkia Devoll<sup>1</sup> jemi informuar se: “...në zbatim të nenit 5, pika 2, të Rregullores “Për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në RSH”<sup>2</sup>: “Fëmija që deri në ditën e parë të fillimit të vitit mësimor mbush moshën 3, 4, 5 vjeç, ka të drejtën të regjistrohet në grupin e parë, të dytë, të tretë, sipas moshës që i përket”. Po ashtu “...Regjistrimi i fëmijëve në institucionet arsimore bëhet në të njëjtën periudhë me regjistrimin e fëmijëve në arsimin bazë, me përjashtim të fëmijëve të grupeve të para në kopshte, të cilët kanë të drejtë të regjistrohen me mbushjen e moshës 3 vjeç”. Fëmija S.J. është e datëlindjes 4.12.2019. Pavarësisht se përgjatë vitit shkollor 2022-2023, fëmija është regjistruar në kopshtin “Trëndafilat e Bardhë” në grupin e parë “Dallëndyshet”, kjo është bërë për të frekuentuar dhe socializuar me fëmijët e grupit. Në regjistër, veç frekuentimit ditor nuk ka asnjë vlerësim për fëmijën, jo vetëm për procedurë, por as për nivelin e arritjeve të saj. Pra nuk i është bërë vlerësim pozitiv nga ana e mësueses për arsye të mosfrekuentimit të rregullt, i cili është një faktor kyç për arritjet e fëmijës në procesin mësimor. Në mungesë të këtij vlerësimi pozitiv nga mësuesja, fëmija nuk mund të kalojë në një program tjetër mësimor..”.

Rregullorja e sipërcituar përcakton *rregullat e detyrueshme për zbatim* nga institucionet arsimore dhe punonjësit e tyre në sistemin arsimor parauniversitar në RSH, në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor<sup>3</sup>, me përjashtim të arsimit profesional, i cili rregullohet me kuadër ligjor e nënligjor të posaçëm<sup>4</sup>.

Gjithashtu, edhe ju, si drejtori e Kopshtit “Trëndafilat e Bardhë” e keni informuar institucionin e Avokatit të Popullit<sup>5</sup> se “...Fëmija S.J., e datëlindjes 4.12.2019, lindur në Korçë dhe banuese në Bilisht/Devoll, së bashku me nënën e saj, është paraqitur pranë drejtorisë së kopshtit në datën 4.12.2022 dhe ka kërkuar të regjistrohet në grupin e parë me mësuese znj.F.M. Që në

<sup>1</sup>Me shkresën nr.3774/1 prot., datë 31.10.2023

<sup>2</sup>Urdhër nr.31, datë 28.01.2020 Për miratimin e Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me shkresën nr.730 prot., datë 28.01.2020 të Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

<sup>3</sup> Pika 1 e nenit 1 të Rregullores

<sup>4</sup> Pika 3 e nenit 1 të Rregullores

<sup>5</sup> Referuar shkresës nr.272 prot., datë 31.10.2023

momentin e takimit, në prani të mësueses F.M., si dhe të gjithë prindërve, i është bërë me dije se cilat janë dokumentet e regjistrimit dhe se fëmijës, gjatë këtyre muajve të qëndrimit në këtë kopësht e deri në përfundim të vitit shkollor, do t'i ofrohet përkujdesje maksimale, por nuk do t'i bëhet asnjëlloj vlerësimi pozitiv, nëse nuk ka frekuentim të rregullt gjatë ditëve mësimore dhe në vitin shkollor 2023-2024 do të regjistrohet përsëri në grupin e parë, sipas udhëzimit të MAS. Këto informacione prindi i fëmijës nuk i ka kontestuar as me gojë e as me shkrim...”.

Në zbatim të pikës 5 të nenit 5, të Rregullores “Për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në RSH” (2020), fëmija është regjistruar në grupin e parë “Dallëndyshet” në këtë kopësht me mësuesen që dëshironte prindi, znj.F.M., në datën 7.12.2022 me dorëzimin, veç dokumenteve të tjera, edhe të certifikatës së vaksinimit. Fëmija S.J. e ka frekuentuar pjesërisht kopshtin gjatë periudhës 7.12.2022-14.06.2023 (në dhjetor 2022 vetëm 1 orë, asnjë ditë në janar 2023, vetëm 5 ditë mësimore në shkurt 2023, 6 ditë mësimore në mars 2023, 4 ditë orë mësimore në prill 2023, 14 ditë mësimore në maj 2023 dhe 9 ditë mësimore në qershor 2023), me afërsisht 21% të ditëve mësimore në total. Në periudhën e verës kur programi mësimor ka mbaruar dhe frekuentimi i kopshtit është i lirë, fëmija nuk është paraqitur fare në kopësht.

Në vijim, e konsiderojmë të nevojshme t'ju informojmë me disa përcaktime të legjislacionit shqiptar. Konkretisht Ligji nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në RSH” , i ndryshuar, përcakton në nenin 21 se: “1.Arsimi parashkollor synon zhvillimin shoqëror, intelektual e fizik, të çdo fëmije, ushtrimin e rregullave themelore të sjelljes e të higjienës, kultivimin e vlerave, si dhe përgatitjen për arsimin fillor. 2. Arsimi parashkollor ndiqet nga fëmijët e moshës nga tre deri në gjashtë vjeç. Fëmijëve të moshës pesë vjeç u mundësohet ndjekja e klasës përgatitore edhe pranë shkollave të arsimit bazë, me synim integrimin në arsimin e detyruar”.

Sistemi arsimor parauniversitar funksionon mbi bazën e decentralizimit dhe autonomisë së institucioneve arsimore<sup>6</sup>. Shërbimi arsimor mbështetet dhe vlerësohet mbi bazën e standardeve. Vlerësimi është i brendshëm dhe i jashtëm<sup>7</sup>. Në sistemin arsimor parauniversitar të vendit tonë funksionojnë **kopshtet**, shkollat dhe institucionet plotësuese, të cilat janë publike ose private<sup>8</sup>.

<sup>6</sup> Pika 9 e nenit 6 të Ligjit nr.69/2012, i ndryshuar

<sup>7</sup> Pika 11 e nenit 6 të Ligjit nr.69/2012, i ndryshuar

<sup>8</sup> Neni 14 i Ligjit nr.69/2012

Neni 44 i këtij ligji ka përcaktuar se: “Kurrikula zhvillohet si një e tërë për të gjitha nivelet arsimore, për sa i përket formimit të vlerave, aftësive e koncepteve kryesore, si dhe parimeve të mësimdhënies, të të nxënësve dhe të vlerësimit të nxënësve. 2. Kurrikula është në përputhje me ecurinë e zhvillimit fizik, mendor, shoqëror, etik të nxënësve dhe veçoritë e tyre individuale të të nxënësve. 3. Kurrikula hartohet dhe zbatohet në bazë të kompetencave themelore të nxënësve. 4. Kurrikula, sipas niveleve arsimore dhe klasave, hartohet dhe zhvillohet në bazë të kornizës kurrikulare të arsimit parauniversitar. 5. Kurrikula mishëron parimin e integritit nëpërmjet fushave të të nxënësve dhe lëndore”.

Arsimi bazë me kohë të plotë është i detyrueshëm për të gjithë fëmijët që janë shtetas shqiptarë me banim në Republikën e Shqipërisë nga moshën gjashtë vjeç deri në moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç, me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë ligj<sup>9</sup>.

Sqarojmë gjithashtu, se pika 2 e nenit 6 të Rregullores “Për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në RSH”, përcakton se “Kopshti e realizon veprimtarinë e tij sipas udhëzimit për vitin shkollor që nxjerr ministria”<sup>10</sup>.

Aktualisht kemi marrë dijeni se fëmija ende nuk po e frekuenton kopshtin, pra po qëndron në shtëpi. Udhëzimi nr.15/2023 i Ministrisë së Arsimit të Arsimit dhe Sportit, vë theksin tek prioriteti që ka pjesëmarrja e fëmijëve 3-6 vjeç në arsimin parashkollor (neni 5/b) dhe ndërgjegjësimi i prindërve për rëndësinë e frekuentimit të kopshtit nga fëmijët e moshës 3-6 vjeç (neni 5/g).

Institucioni i Avokatit të Popullit në trajtimin e çdo lloj rasti ankese apo kërkesë të shtetasve, ka nënvizuar se **interesi më i lartë i fëmijës** duhet të jetë kryesori në çdo lloj vendimmarrje të organeve shtetërore. Në sistemin e monitorimit të zbatimit të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, Avokati i Popullit synon që jo vetëm të promovojë të drejtat e fëmijëve, por dhe të luajë rolin parandalues, mbrojtës, nxitës dhe proaktiv për aksesin në shërbimet e ndryshme ekonomike, arsimore, shëndetësore që ndikojnë tek fëmijët.

Pra, përveç zgjidhjes së problemit konkret, përpiqemi të promovojmë interesin më të lartë të fëmijës, si parësori në punën e administratës publike, duke pasur parasysh gjithashtu që fëmijët, për shkak të veçorive të moshës, të mungesës së pjekurisë fizike dhe intelektuale, kanë nevojë për mbrojtje dhe vëmendje të veçantë nga familja dhe institucionet shtetërore. Autoritetet

<sup>9</sup> Pika 4, neni 22 i Ligjit nr.69/2012 i ndryshuar, aksesuar në [https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2017/10/Ligji\\_Parauniversitar.pdf](https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2017/10/Ligji_Parauniversitar.pdf)

<sup>10</sup> Udhëzimi nr.15/2023 “Për vitin shkollor 2023-2024 në sistemin arsimor parauniversitar”

publike dhe jopublike duhet të kenë në konsideratë interesin më të lartë të fëmijës, në të gjitha veprimet dhe vendimet që merren në lidhje me fëmijën<sup>11</sup>.

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 18 të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës, ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, shteti duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për t’u siguruar fëmijëve, prindërit e të cilëve janë në marrëdhënie pune, të drejtën të përfitojnë nga shërbimet dhe lehtësitë e kujdesit për fëmijët për të cilat janë ngritur.

Kopshti është një qendër shërbimi edukative dhe shoqërore, e hapur për të gjithë fëmijët dhe mundëson, së bashku me familjen, mirërritjen e tyre dhe edukimin<sup>12</sup>. Nuk duhet harruar, se frekuentimi nga fëmijët i institucioneve parashkollore, duke filluar nga çerdhja dhe kopshti, janë përvoja e parë e jetës kolektive për fëmijët, pasi ndërveprimi social përbën rrënjët e zhvillimit të shëndetshëm dhe, një ndër kushtet më të rëndësishme për zhvillimin e personalitetit të tyre. Çdo moment i jetës në çerdhe dhe kopshte ka një domethënie të rëndësishme për fëmijët dhe organizimi i përditshëm i shërbimit duhet përqëndruar në sigurimin e mirëqenies dhe të pavarësisë së tyre. Për fëmijën, në veçanti, kjo nënkupton ndërveprimin në një mjedis duke njohur, jo vetëm fëmijë të tjerë, por edhe të rritur, të ndryshëm nga familjarët, dhe, që shoqërohet me ndryshime pozitive, si për fëmijën, ashtu edhe për familjen e tij.

Kopshti është një institucion i arsimit parashkollor, i cili synon zhvillimin shoqëror, intelektual e fizik, të çdo fëmije, ushtrimin e rregullave themelore të sjelljes e të higjienës, kultivimin e vlerave, si dhe përgatitjen për arsimin fillor. Arsimi parashkollor nuk është i detyrueshëm, megjithatë shumë i nevojshëm në formimin e fëmijëve, pasi është një e drejtë e fëmijëve për t’u arsimuar.

Nisur dhe nga fakti që fëmija aktualisht ka mbushur moshën 4 vjeç dhe po qëndron në shtëpi pa e frekuentuar kopshtin, e gjejmë me vend t’ju drejtohem për vlerësimin e kësaj situatë në optikën e interesit më të lartë të fëmijës e duke marrë për bazë dhe qëndrimin dhe dëshirën e vetë prindit të vajzës. Vetëm duke e kryer këtë lloj vlerësimi, do të kontribuojmë në arritjen

---

<sup>11</sup> Pika 2, e nenit 6, të ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

<sup>12</sup> Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashihet në nenin 21 se “...*arsimi parashkollor synon zhvillimin shoqëror, intelektual dhe fizik të çdo fëmije, ushtrimin e rregullave themelore të sjelljes e të higjienës, kultivimin e vlerave, si dhe përgatitjen për arsimin fillor. Arsimi parashkollor ndiqet nga fëmijët e moshës nga tre deri në gjashtë vjeç. Fëmijëve të moshës pesë vjeç u mundësohet ndjekja e klasës përgatitore edhe pranë shkollave të arsimit bazë, me synim integrimin në arsimin e detyrueshëm...*”.

e qëllimit, kthimin e vajzës në frekuentimin e kopshtit, për të marrë shërbimet dhe kujdesin njësoj si bashkëmoshatarët e saj. Mosfrekuentimi i kopshtit prej fëmijës dhe fakti që kryerja e programit të grupit të parë nuk është kriter apo pengesë ligjore për të avancuar në grupet e kopshtit, duhen ri-vlerësuar nga ana juaj në këtë rast. Ndërmjetësimi dhe vlerësimi duhen bërë në bashkëpunim mes prindit të fëmijës dhe juve si institucion shtetëror duke u përpjekur të shmangen qëndrime strike që janë në dëm të fëmijës.

Pavarësisht se, ndryshe nga arsimi bazë, ndjekja e kopshtit nuk është e detyrueshme, interesi më i lartë i fëmijës në këtë rast është të frekuentojë kopshtin dhe të regjistrohet në grupin që është më i përshtatshëm për të, pasi të jetë marrë dhe mendimi i prindit dhe vetë fëmijës. Edhe vetë prindi duhet të ketë parasysh interesin më të lartë të fëmijës, si dhe të jetë proaktiv për të regjistruar fëmijën që të frekuentojë rregullisht kopshtin.

Me qëllimin dhe dëshirën e mirë, në funksion të garantimit të interesit më të lartë të fëmijës, i cili nënkupton të drejtën e fëmijës për të patur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, duke konsideruar se institucionet parashkollore përbëjnë bazën e piramidës së përgatitjes dhe zhvillimit të fëmijëve, lutemi, ta interpretoni këtë rast, e ta zgjidhni me mirëkuptim mes jush si institucion dhe prindërve të fëmijës, nisur nga interesi më i lartë i fëmijës.

Theksojmë, se është detyrë e të gjithëve së bashku, të respektojmë dhe mbrojmë të drejtat e fëmijës, duke zbatuar parimin e interesit më të lartë të tyre. Ju lutemi na vini në dijeni për zgjidhjen që do t'i jepni këtij rasti.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

**K O M I S I O N E R**

**OLTA ALIAJ**